



# KOMUNA E MALISHEVËS



# BULETINI

Nr. 112-Tetor 2012 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Pamje nga rregullimi i zyrës së pritjes dhe shërbimit të gjendjes civile në Komunën e Malishevës



## Përmbajtja

|                                                                                         |    |
|-----------------------------------------------------------------------------------------|----|
| Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve .....                                            | 3  |
| Kryetari priti udhëheqësit e LMT-së në Malishevë .....                                  | 3  |
| Malisheva vend i qetë dhe i sigurt .....                                                | 4  |
| Zëvendësministri i MPMS, vizitoj Malishevën .....                                       | 4  |
| USAID dhe Komuna, modernizojnë zyrat e gjendjes civile .....                            | 5  |
| Prezantohet indeksi i konkurrencës për Komunën e Malishevës për vitin 2012 .....        | 6  |
| Malisheva përgatitet për shënimin e 100 vjetorit të Pavarësisë së shtetit Shqiptar..... | 7  |
| Diskutohen mundësitë e fillimit të ndërtimit të TS 110/10/20 KV .....                   | 7  |
| Komiteti për komunitete mbajti mbledhjen e gjashtë të radhës .....                      | 8  |
| Familja e veteranit Muhamet Krasniqi, bëhet me shtëpi .....                             | 8  |
| Propozohet emërtimi i të gjitha rrugëve dhe objekteve .....                             | 9  |
| Asambleja dërgoi në shqyrtim publik rregulloren për përdorimin e gjuhëve .....          | 10 |
| Pograjc: KFOR-i do të vazhdoj me punën e mirë në Kosovë .....                           | 10 |

## Nga mbledhja e Këshillit të Drejtorëve

### **Malishevë, 1 tetor**

Këshilli i Drejtorëve, i udhëhequr nga Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt të së hënës, ku janë diskutuar një varg çështjesh, që kanë të bëjnë me punën e qeverisë komunale të Malishevës në përgjithësi.

“Mënyra profesionale e përgatitjes së buxhetit komunal, për vitin 2013 dhe planifikimi i mirë i buxhetit, i miratuar javën e kaluar nga Asambleja Komunale, është mirëpritur nga ana e këshilltarëve komunal”, tha kryetari Kilaj.

“Edhe përfundimi i projekteve që kanë plotësuar nevojat e përgjithshme të infrastrukturës, ka ndikuar që buxheti të pritet mirë dhe pikërisht përfundimi i projekteve të infrastrukturës së përgjithshme, e dallon Komunën e Malishevës, prej komunave tjera”, tha drejtori për buxhet dhe financa, z.Vesel Krasniqi.

Në këtë mbledhje, u paraqit nevoja për zgjerimin e urës kryesore mbi lumin “Mirusha”, në rrugën “Rilindja Kombëtare”, brenda qytetit të Malishevës.

Po ashtu, kryetari Kilaj, kërkoi që të vazhdohet furnizimi me ujë për pije, për rastet sociale, të cilat e kanë problem sigurimin e ujit, për shkak të thatësisë së madhe. “Uji i pijes, është i domosdoshëm dhe për këtë, duhet të vazhdohet furnizimi me ujë për rastet sociale, të cilat nuk mund të sigurojnë ujin”.

## Kryetari priti udhëheqësit e LMT-së në Malishevë

### **Malishevë, 2 tetor**

Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot në një takim lamtumire, përkatësisht njohës komandantin në largim të njësisë LMT të KFOR-it në Malishevë, kapitenin A. Rizzo dhe pasardhësin e tij, kapitenin e ardhshëm J. Oser, të cilët i ka falënderuar për punën dhe bashkëpunim e deritanishëm.

“Faleminderit për punën që keni bërë këtu në Malishevë dhe në Kosovë në përgjithësi. E vlerësojmë lartë punën e LMT-së dhe të KFOR-it në përgjithësi, nëpër komuna. Ne KFOR-in e llogarisim si ushtri tonën, pasi ka ndihmuar shumë edhe në ndërtimin e vendit, andaj edhe ju duhet të ndiheni si në vendin tuaj”, ka thënë kryetari Kilaj, në takimin me dy eprorët e njësisë së LMT-së zvicerane në Malishevë. Më pas, kryetari Kilaj, e ka falënderuar edhe komandantin në largim të njësisë së LMT-së në Malishevë, për bashkëpunim e mirë me komunën, si dhe i ka dëshiruar mirëseardhje komandantit të ri.



Në anën tjetër kapiteni A. Rizzo, tha se “bashkëpunimi mes LMT-së, komunës dhe kryetarit, ka qenë i shkëlqyer dhe unë ju falënderoj për këtë”. Ai më pas, shprehi edhe kënaqësinë e tij, për të arriturat në Malishevë, i cili më pas, prezantoi edhe pasardhësin e tij, kapitenin J.Oser. Ky i fundit, u shpreh i gatshëm, për vazhdimin e bashkëpunimit, edhe në të ardhmen.

*Nga mbledhja e KKSB-së*

## **Malisheva vend i qetë dhe i sigurt**

### **Malishevë, 4 tetor**

Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), në mbledhjen e mbajtur sot, e ka vlerësuar situatën e përgjithshme të sigurisë në Komunën e Malishevës të qetë dhe stabile, pa tendencë të prishjes së kësaj situate.

Sipas drejtorisë për Mbrojtje dhe Shpëtim, gjatë muajve të fundit ka pasur shume raste të zjarreve, ndërsa njësia e zjarrfikësve dhe shpëtimit, ka kryer rreth treqind intervenime të ndryshme, përfshi këtu edhe ndihmën në Komunën e Dragashit, për shuarjen e zjarreve.

Zzv/komandanti i stacionit policor në Malishevë, togeri Istref Bytyçi, në raportin e policisë, për tre muajt e fundit, tha se “gjendja është e qetë dhe stabile, pa indikacione për përkeqësim të situatës së sigurisë së përgjithshme”. Sipas policisë, rastet e zjarreve gjatë verës, janë menaxhuar mirë dhe bashkëpunimi me zjarrfikësit dhe organet komunale, ka qenë i mirë. “Gjatë këtyre tre muajve, shqetësuese kanë qene vjedhjet, në veçanti vjedhja e derivateve të kompanisë, që po kryen punimet në trasenë e autostradës”, tha togeri Bytyçi.

Edhe shoqëria civile e Malishevës e ka vlerësuar të qetë dhe stabile situatën e sigurisë së përgjithshme, përderisa ka ngritur çështjen e qenve endacak, të cilët janë bërë shqetësim për qytetarët, në veçanti për fëmijët.

Në anën tjetër, drejtori Drejtorisë për Bujqësi, z.Sinan Kryeziu, i ka njoftuar anëtarët e KKSB-së, për gjendjen e pyjeve, sipas të cilit “ në territorin e komunës së Malishevës ka mbi 15 mijë hektar pyje, gjysma prej tyre në sektorin publik, por që po dëmtohen, jo vetëm nga zjarret, por edhe nga faktori njeri”.

## **Zëvendësministri i MPMS, vizitoj Malishevën**

### **Malishevë, 9 tetor**

Kryetari i Komunës së Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim, zëvendësministrin e Ministrisë Punës dhe Mirëqenies Sociale, z. Fatmir Shurdhaj, e që ky i fundit shoqërohej edhe nga Drejtori i Departamentit të Punës dhe Punësimit, z. Defrim Arifaj.

Në këtë takim janë diskutuar çështjet që ndërlidhen me aspektin e gjendjes sociale në komunën e Malishevës, mundësitë e hulumtimeve dhe identifikimin e rasteve, se a i plotësojnë vërtet kriteret të gjithë ata që janë në asistencë sociale.

Me këtë rast, janë vizituar edhe punimet e ndërtimit të trotuareve, nga Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare deri te Qendra e Kompetencës, projekt i financuar nga Komisioni Europian, i implementuar nga IOM-i ndërsa janë punësuar rreth 80 persona të përzgjedhur nga Qendra për Punësim, Njëkohësisht është vizituar edhe objekti, ku aktualisht funksionon Qendra për Punë Sociale, me ç'rast janë shqyrtuar mundësitë e renovimit të këtij objekti.

## **USAID dhe Komuna, modernizojnë zyrat e gjendjes civile**

### **Malishevë, 10 tetor**

Zyrat e gjendjes civile në Komunën e Malishevës, prej sot, janë të pajisura me mjete moderne të punës dhe me ambiente më të përshtatshme edhe për qytetarët, pasi Komuna e Malishevës, ka fituar një projekt nga programi DEMI i USAID-it, me qëllim të rritjes së efikasitetit në ofrimin e shërbimeve për qytetarët.

“Komuna e ka fituar këtë projekt nga USAID-DEMI programi, pasi DEMI ka vlerësuar se ka ngritje të efikasitetit në shërbime ndaj qytetarëve, andaj për ta rritur edhe më tej këtë efikasitet, ka financuar në realizimin e këtij projekti”, tha koordinatori i komunës, për DEMI programin për Malishevë, z. Muharrem Morina.

“Në emër të Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme e falënderoj DEMI-n për përkrahjen në sigurimin e këtyre pajisjeve, pasi tani dukshëm rritet efikasiteti në punë dhe ka kushte më të mira për ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve”, tha drejtori i Administratës së Përgjithshme në Komunën e Malishevës, z. Haki Krasniqi. “Tani zyra e pritjes dhe zyrat e gjendjes civile, janë në një vend dhe kjo e rrit efikasitetin e punës dhe ofrimin e shërbimeve më të shpejta për qytetarët, ndërsa karriget dhe raftet për vendosjen e kërkesave, të cilat gjenden në hollin e komunës, në kuadër të këtij projekti, mundësojnë që qytetarët drejtpërdrejt t'i marrin dhe plotësojnë kërkesat e tyre”, tha drejtori Krasniqi.

Projekti i bashkëfinancuar nga USAID-DEMI dhe Komuna, kap një shumë prej 25 790 euro, ku USAID ka marrë pjesë me 20 632 euro, ndërsa komuna me 5 158 euro. Pajisjet e siguruar për këto zyre, janë: kompjuter dhe printer, tavolina pune, karrige, rafte, kondicioner dhe televizor.

“DEMI programi u përgjigjet prioriteteve të komunës, në këtë rast ofrimi i shërbimeve më të mira për qytetarët, ka qenë prioritet i Komunës së Malishevës. DEMI do të vazhdojë të përkrahë Komunën e Malishevës, edhe me projekte tjera”, tha zyrtari i USAID-it në kuadër të programit DEMI, z.Nijazi Kuçi.

*Nga USAID/BEEP*

## **Prezantohet indeksi i konkurrencës për Komunën e Malishevës për vitin 2012**

### **Malishevë, 10 tetor**

Programi i USAID/BEEP-it, për Përmirësimin e Mjedisit Afarist në Kosovë, ka mbajtur sot një takim me zyrtarët komunal dhe bizneset në Komunën e Malishevës, me ç'rast është prezantuar indeksi i konkurrencës për Komunën e Malishevës, për vitin 2012.

Në takim përveç zyrtarëve komunal, përfshirë këtu nënkryetarin e Komunës z. Rexhep Mazreku dhe drejtorët e drejtorive komunale, merrnin pjesë edhe përfaqësues të bizneseve në Komunën e Malishevës.

Sipas këtij indeksi, krahasuar me vitin e kaluar Komuna e Malishevës, ka shënuar ngritje të performancës në raport me bizneset.

Haxhi Seferqaj, menaxher regional i këtij projekti ka thënë se “krahasuar me vitin e kaluar, këtë vit Komuna e Malishevës, ka shënuar ngritje të performancës në raport me bizneset, për çka edhe ju përgëzoj.”

Ky indeks i konkurrencës, të cilin e prezantoj z. Hazër Shehu, ka këtë përmbajtje: kuptimi i indeksit të konkurrencës së komunave; rezultatin e përgjithshëm të Komunës së Malishevës, pengesat për nisjen e biznesit, transparencën, parashikueshmëria dhe pjesëmarrja, kostoja kohore e pajtueshmërisë rregullative, taksat dhe tarifat, administrata komunale, fuqia punëtore dhe shërbimet mbështetëse të biznesit, infrastruktura komunale, sëot analiza dhe rekomandimet.

Me këtë rast, drejtori i Drejtorisë së Financave, z. Vesel Krasniqi, pasi ka përshëndetur përfaqësuesit e USAID-BEEP, përfaqësuesit e bizneseve dhe të pranishmit të tjerë, në lidhje me indeksin ka shtuar se “në raport me bizneset, Komuna e Malishevës ka bërë edhe më shumë, krahasuar me statistikën e prezantuar, edhe pse shihet qartë se ka ngritje të dukshme të performancës në raport me bizneset”. Z. Krasniqi u bëri thirrje bizneseve që të marrin pjesë në debate publike, sepse pjesëmarrja e shton edhe më shumë bashkëpunimin komunal - biznes, e poashtu bizneset kanë mundësi që drejtpërdrejt të japin kontributin e tyre, sidomos kur është fjala për debate buxhetore. Në anën tjetër, nga ana e përfaqësuesve të bizneseve pati propozime që tatimi për objekte bujqësore të jetë më i ulët, krahasuar me objektet e banimit apo ato afariste.

## **Malisheva përgatitet për shënimin e 100 vjetorit të Pavarësisë së shtetit Shqiptar**

### **Malishevë, 15 tetor**

Në Malishevë, kanë filluar përgatitjet për shënimin e 100 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, duke iu bashkuar kështu shënimeve festive të jubileut të njëqind, në të gjitha trojet shqiptare. Për shënimin e 100 vjetorit të Pavarësisë, në Malishevë, do të ketë aktivitete të ndryshme, që do të organizohen nga Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport. Kështu u tha sot, në mbledhjen e Këshillit të Drejtorëve.

“Të përgatiten dhe organizohen mirë të gjitha aktivitetet që planifikohen nga Drejtoria për Kulturë, Rini e Sport, dhe muaji Nëntor, të jetë muaj festiv në Malishevë”, ka thënë kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, në takimin e sotëm të rregullt, të Këshillit të Drejtorëve.

Në këtë mbledhje të qeverisë komunale, ka diskutuar edhe çështje të tjera që lidhen me punën e drejtorive, përderisa drejtorët kanë raportuar për aktivitete e tyre gjatë javës që lamë pas dhe detyrat për javën në vijim.

Sipas drejtorit për bujqësi, z.Sinan Kryeziu, “nga grantet qeveritare, kanë përfituar tetë fermer nga Komuna e Malishevës, me një shumë të përgjithshme, rreth 300 mijë euro. Ky grant do të përdoret për rritjen e kapaciteteve të fermave të tyre, sidomos në kultivimin e pemëve, përderisa edhe disa fermer tjerë pritet të përfitojnë nga grantet e Bankës Botërore, për bujqësi”.

Ndërsa, drejtori i urbanizmit, z.Esat Paçarizi, njoftoj se, pritet të rriten kapacitetet e ujësjellësit në Maxharrë, përmes një projekti, që do të financohet nga komuna dhe “Hidroregjioni”.

## **Diskutohen mundësitë e fillimit të ndërtimit të TS 110/10/20 KV**

### **Malishevë, 17 tetor**

Kryetari i Malishevës, z. Isni Kilaj, ka pritur në takim një delegacion nga sektori për zhvillimin e rrjetit Operator të Sistemit të Tregut dhe Transmisionit në Kosovë (KOSTT), prirë nga zonja Bukurie Dauti, menaxhere e këtij sektori.

Në takim janë diskutuar mundësitë e fillimit të ndërtimit të një trafostacioni TS 110/10/20 kv, kërkesë kjo e kamotshme e qeverisë së Malishevës dhe nevojë për banorët e kësaj komune. Me këtë rast është kërkuar që komuna të siguroj lokacion të përshtatshëm për ndërtimin e tij.

Zonja Dauti tha se “ne do të dalim në terren dhe do të shohim mundësitë e harmonizimit tuaj si komunë dhe distribucionit të KEK-ut këtu në Malishevë, për ndarjen e lokacionit të përshtatshëm për realizimin e këtij projekti”. Në anën tjetër kryetari Kilaj, ka ofruar përkrahje të pakontestueshme në këtë drejtim, pasi që sipas tij “kjo edhe është kërkesë e jona e kahershme, të cilën e kemi adresuar në instancat kompetente, sepse është nevojë për banorët e Komunës së Malishevës”.

Njëkohësisht z. Kilaj, ka falënderuar delegacionin e KOSTT-it për prezencën e tyre në Malishevës, duke u premtuar se sa i përket ndarjes së lokacionit për ndërtimin e trafostacionit, nuk do të ketë fare problem.

## **Komiteti për komunitete mbajti mbledhjen e gjashtë të radhës**

### **Malishevë, 19 tetor**

Komiteti për Komunitete, organ i formuar nga Asambleja Komunale e Malishevës, ka mbajtur sot, mbledhjen e saj të gjashtë të rregullt.

Me këtë rast është shqyrtuar projekt rregullorja për përdorimin e gjuhëve në Komunën e Malishevës, e cila është miratuar si rekomandim për procedim në Komitetin për Politikë dhe Financa.

Sqarime më në detale për këtë projekt rregullorë, para anëtarëve të këtij komiteti, ka dhënë këshilltari ligjor në zyrën e kryetarit, z. Muharrem Morina.

Humanisti Shemsi Mazreku, ndërtoi një shtëpi për veteranin e luftës Muhamet Krasniqi

## **Familja e veteranit Muhamet Krasniqi, bëhet me shtëpi**

### **Malishevë, 25 tetor**

Familja e veteranit të luftës së UÇK-së, Muhamet Krasniqi, nga fshati Bardh, prej sot është me shtëpi të re, falë ndihmës që i ka dhënë humanisti nga Malisheva, z. Shemsi Mazreku, i cili sot ja dorëzoi çelësat e shtëpisë familjes Krasniqi. Në këtë ceremoni, morën pjesë edhe Kryetari i Malishevës, z. Isni Kilaj, deputetja e Kuvendit të Kosovës, znj. Hasime Krasniqi, dhe përfaqësues të shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së.



“Në emër të institucionit të komunës, e falënderoj humanistin Shemsi Mazreku, për këtë vepër të madhe, vepër e cila është shembull edhe për të gjithë ata që kanë mundësi të ndihmojnë në këtë mënyrë”, tha mes tjerash Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, duke falënderuar humanistin Mazreku, për këtë vepër të madhe humane. “Ne si komunë, që relativisht jemi e pazhvilluar, jemi munduar që t’ju ndihmojmë familjeve në nevojë, dhe vetëm gjatë këtij viti, kemi ndihmuar 35 familje në ndërtimin apo meremetimin e shtëpive, ndërsa kjo është shtëpia e tretë që gjatë këtij viti, ndërtohet nga humanistët si Shemsiu”, tha kryetari Kilaj.

Ndërsa deputetja në Kuvendin e Kosovës, znj.Hasime Krasniqi, pasi e falënderoi Kryetarin Kilaj, për ndihmën që po ju ofron familjeve në nevojë, si dhe humanistin Mazreku, për këtë vepër të madhe, tha se “ne të gjallët e kemi obligim moral ti ndihmojmë veteranët e luftës së UÇK-së”. “Uroj të gjenden donator dhe humanist të tjerë, për ti ndihmuar rastet e ngjashme. Zoti i ndihmoftë të gjithë ata që kanë mundësi të ndihmojnë”, tha në fund të fjalës së saj, znj, Krasniqi.

Ndërsa vet donatori, z.Shemsi Mazreku, pasi e uroi familjen e veteranit Muhamet Krasniqi, për shtëpinë, dhe falënderoi të pranishmit, deklaroi se, “këtë ndihmë, e ka bërë në emër të axhës së tij”.

“Kam jetuar në kushte shumë të vështira materiale dhe kam qenë shumë keq, sidomos për banim, për familjen e time katër anëtarëshe, por besoj se që nga sot, do jem shumë më mirë, pasi tani kam ku të jetoj”, the veteranit Muhamet Krasniqi, i cili falënderoi donatorin Mazreku, Komunën e Malishevës dhe të gjithë ata që kanë kontribuar në ndërtimin e shtëpisë.

## **Propozohet emërtimi i të gjitha rrugëve dhe objekteve**

### **Malishevë, 29 tetor**

Në mbledhjen e sotme të Këshillit të Drejtorëve, të udhëhequr nga Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, u diskutua dhe u dha propozimi që në kuadër të shënimeve për 100 vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë, të gjitha rrugët dhe objektet tjera publike, në tërë territorin e Komunës së Malishevës, të kenë emërtimet e tyre, dhe në këtë drejtim, përparësi do të kenë emrat e dëshmorëve të kombit.

“Ky propozim, do të dorëzohet për shqyrtim dhe miratim Asamblesë Komunale të Malishevës, si i vetmi organ vendimmarrës për emërtimet në territorin e Malishevës, ndërsa përmes emërtimit me emrat e dëshmorëve, do të nderohet vepra e tyre për çlirimin e Kosovës”, tha kryetari i Kilaj.

Në mbledhjen e sotme, u diskutua edhe për dhënien e lejes për ndërtimin e një trafostacioni 110 kv, për territorin e Malishevës, i cili sipas kryetarit Kilaj, “është investimi më kapital për zhvillimin e Malishevës”.

## **Asambleja dërgoi në shqyrtim publik rregulloren për përdorimin e gjuhëve**

### **Malishevë, 30 tetor**

Asambleja Komunale e Malishevë, në mbledhjen e dhjetë të rregullt për këtë vit, ka shqyrtuar projekt rregulloren për Përdorimin e Gjuhëve në Komunën e Malishevës, si dhe para këshilltarëve komunal, është paraqitur edhe raporti financiar nëntëmujor për vitin 2012.

Këshilltarët Komunal, e kanë bërë shqyrtimin e projekt rregullore për Përdorimin e Gjuhëve në Komunën e Malishevës dhe më pas, me shumicë të votave, e kanë dërguar për shqyrtim publik këtë projekt rregullore, e cila pasi të debatohet me qytetarë, do të kthehet në Asamble për votim.

Po ashtu në mbledhjen e sotme të Asamblesë Komunale, është prezantuar raporti financiar nëntëmujor i buxhetit për vitin 2012, ndërsa në pyetjet e këshilltarëve komunal, është përgjigjur drejtori për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi.

Zv/komandanti i KFOR-it, Gjeneral Brigade Bojan Pograjc vizitoi Malishevën

## **Pograjc: KFOR-i do të vazhdoj me punën e mirë në Kosovë**

### **Malishevë, 31 tetor**

Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj, ka pritur sot, zëvendës komandantin e KFOR-it, Gjeneral Brigade-Bojan Pograjc, me të cilin kanë biseduar për rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, si dhe për bashkëpunimin me njësinë ndërlidhëse të KFOR-it, LMT dhe me KFOR-in në Malishevë.

“Kemi kënaqësi për vizitën tuaj në Malishevë, pasi jo rastësisht Malishevën e vizitojnë miqtë e mirë dhe miqtë e mëdhenj të vendit tonë, përfshi edhe sllovenët, vendin prej nga vini ju”, i tha kryetari Kilaj, gjeneralit Pograjc, me rastin e vizitës së tij në Malishevë. “Malisheva ka 70 mijë banorë, prej të cilëve 15 mijë, jetojnë dhe punojnë në vende tjera, përfshi edhe Slloveninë, ku kemi një komunitet dhe lidhje të fuqishme me Slloveninë”, tha Kilaj.

Ndërsa gjenerali Pograjc, i cili tash e dy muaj është zëvendëskomandant i KFOR-it, njoftoi se prej se është “në këtë pozitë udhëheqëse, Malisheva është komuna e parë të cilën e viziton”. “Jo rastësisht sot po e vizitoj Malishevën, dhe njëra prej arsyeve është ajo që t’ja shtrij dorën “Qytetarit të nderit” të Arkanzasit, vendit prej nga vjen edhe sekretarja e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, zonja Hillary Clinton, e cila po ashtu është në vizitë në Kosovë”.

Më pas gjenerali Pograjc, u interesua për rrjedhat e përgjithshme në Malishevë, për të cilat e njoftoi Kryetari i Malishevës, z.Isni Kilaj. “Malisheva, është një komunë mesatare e Kosovës, dhe kryesisht vend bujqësor, një komunë me 45 vendbanime, komunë e cila ka dalë rreth 90 % e shkatërruar nga lufta, mirëpo, jemi një komunë e cila, ka filluar të zhvillohet shpejt, ku sot çdo fshat është i lidhur me rrugë të asfaltuara, me shkollë të reja, ujësjellës dhe kanalizime”, tha kryetari Kilaj, duke e njoftuar gjeneralin për zhvillimet në Malishevë. Po ashtu, zëvendës komandanti i KFOR-it, u njoftua me të gjitha zhvillimet në Malishevë, projektet kapitale, projektet që janë në vazhdim e sipër dhe të tjera.

“Bashkëpunimi me KFOR-in dhe me ekipin ndërlidhës të saj në Malishevë, LMT-ën zvicerane, është i shkëlqyer”, tha kryetari Kilaj, duke e njoftuar për bashkëpunimin me ekipin e LMT-së në Malishevë.

“Ju premtoj se ekipet tona, si LMT-ja, do të vazhdojnë punën e tyre të shkëlqyer, pasi të gjithë pjesëtarët e LMT-së, me në krye kapitenin Oser, janë profesionist dhe të mirë, dhe ky është edhe qëllimi i KFOR-it”, tha zëvendës komandanti i KFOR-it, Gjeneral Brigade-Bojan Pograjc.

“Ju i nderuar kryetar Kilaj punoni për komunën tuaj, ndërsa unë si përfaqësues i KFOR-it punoj për KFOR-in, por të dytë kemi një qëllim, e ai qëllim është se të dytë punojnë për të mirën e popullit të Kosovës”, tha në fund të takimit, gjenerali Pograjc, zëvendës komandant i KFOR-it.

Përgatitur nga Zyra për Informim Publik